



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme/
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova /Ministry of Internal
Affairs

Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 01/2026
PËR PROCEDURËN E GRADIMIT TË ZYRTARËVE POLICORË

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë,

Në pajtim me nenin 45 dhe nenit 55 nënparagrafi 1.8 të Ligjit për Policinë, me qëllim të zbatimit të tij,

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 01/2026 PËR PROCEDURËN E GRADIMIT TË ZYRTARËVE POLICORË

Neni 1 Qëllimi

Ky udhëzim administrativ përcakton procedurën dhe kriteret për gradimin e zyrtarëve policorë.

Neni 2 Fushëveprimi

Ky udhëzim administrativ zbatohet nga Policia e Kosovës.

Neni 3 Përkufizimet

1. Termat, shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Grada** - nënkupton titullin dhe ose shenjë që mban zyrtari policor në uniformën policore e përcaktuar në Ligjin për policinë e cila shërben për përcaktimin e qartë të zinxhirit komandues dhe hierarkisë;
 - 1.2. **DZHPK** – nënkupton Drejtorinë për Zhvillim të Performancës dhe Karrierës në Policinë e Kosovës;
 - 1.3. **PRIMS** – Nënkupton Sistemin elektronik të menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës;
 - 1.4. **DDBNJ** - nënkupton Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore;
2. Termat, shprehjet dhe shkurtesat e tjera të përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimin e njëjtë si në legjislacionin relevant në fuqi.
3. Përdorimi i emrit në njëren gjini, nënkupton edhe gjininë tjetër.

Neni 4 Parimet udhëzuese

Procesi i gradimit në Policinë e Kosovës është transparent, gjithëpërfshirës, konkurrues, duke siguruar profesionalizëm, integritet, mosdiskriminim dhe meritokraci. Procesi i gradimit reflekton natyrën shumetnike dhe respekton parimet e barazisë gjinore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe Ligjin për Policinë.

Neni 5 **Sistemi i Gradave dhe Avancimit**

1. Në Policinë e Kosovës ekziston Sistemi i gradave për zyrtarët e uniformuar.
2. Sistemi i gradave për zyrtarët policor, është si në vijim:
 - 2.1. Polic i Ri.
 - 2.2. Polic;
 - 2.3. Polic i Lartë;
 - 2.4. Rreshter;
 - 2.5. Toger;
 - 2.6. Kapiten;
 - 2.7. Major;
 - 2.8. Nënkolonel;
 - 2.9. Kolonel;

Neni 6 **Kriteret e përgjithshme për gradim për zyrtar policor**

1. Gradimi i zyrtarëve policor është proces i zhvillimit në karrierë, bazuar në nevojat e Policisë së Kosovës.
2. Kriteret e përgjithshme për gradim janë:
 - 2.1. koha minimale e qëndrimit në gradë;
 - 2.2. koha e qëndrimit në Policinë e Kosovës;
 - 2.3. niveli i kërkuar i arsimimit;
 - 2.4. të mos ketë masë për shkelje të rëndë disiplinore;
 - 2.5. të mos jetë i dënuar për vepër penale;
 - 2.6. të ketë vlerësim të performancës me notën 2.5 apo më lartë në secilin nga tri vitet e fundit;

2.7. kalimi i procedurave të gradimit.

Neni 7

Kriteret e veçanta për gradim për zyrtar policor

1. Përveç kriterëve të përgjithshme, zyrtari policor duhet të plotësojë edhe kriteret e veçanta për marrjen e gradës, si vijon:

1.1. **Polic i Ri** bëhet automatikisht pas përfundimit të trajnimit bazë teorik për zyrtarët policorë;

1.2. **Polic** bëhet automatikisht, pas përfundimit të trajnimit praktik për zyrtar policor;

1.3. **Polic i Lartë** bëhet automatikisht, pas një (1) vit të qëndrimit në gradën “Polic”;

1.4. **Rreshter** të ketë së paku gradën Polic i lartë;

1.5 **Toger** Përvojë pune në gradën paraprake së paku dy (2) vite;

1.6 **Kapiten** Përvojë pune në gradën paraprake së paku dy (2) vite; Kualifikimi shkollor niveli i arsimimit të lartë;

1.7. **Major** Përvojë pune në gradën paraprake së paku dy (2) vite;

1.8. **Nënkolonel** përvojë pune në gradën paraprake së paku dy (2) vite

1.9 **Kolonel:**” përvojë pune në gradën paraprake së paku dy (2) vite ;

2. Përjashtimisht nga kriteret e përcaktuara për gradim sipas këtij neni, dhe me qëllim të sigurimit të funksionimit efektiv operacional dhe plotësisht të nevojave organizative e udhëheqëse të Policisë së Kosovës, zyrtarit policor i cili ka të paktën dhjetë (10) vite përvojë aktive në Policinë e Kosovës dhe i cili nuk ka përfituar gradim përmes proceseve të rregullta të gradimit gjatë kësaj periudhe, i njihet e drejta për t’iu nënshtruar procedurës së veçantë të gradimit, në pajtim me dispozitat e këtij udhëzimi administrativ.

3. Në kuadër të procedurës së veçantë të gradimit nga paragrafi 2 i këtij neni, zyrtari policor mund të aplikojë dhe t’i nënshtrohet procedurës së vlerësimit për fitimin e dy (2) gradave më të larta njëherazi. Në këto raste nuk zbatohen kufizimet lidhur me kohëzgjatjen minimale të qëndrimit në gradën paraprake, me kusht që kandidati t’i plotësojë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për gradim, si dhe standardet profesionale të përcaktuara për gradën përkatëse.

4. Procedura e veçantë e gradimit sipas këtij neni zhvillohet në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës, konkurrencës së hapur, trajtimit të barabartë dhe meritës profesionale. Vlerësimi dhe përzgjedhja e kandidatëve realizohet përmes procedurave objektive të testimit, vlerësimit profesional dhe verifikimit të performancës, në pajtim me këtë udhëzim administrativ.

5. Drejtori i Përgjithshëm mbi bazën e një analize të nevojave për gradim, me vendim vendos për zbatimin e procedurës së veçantë të gradimit kur vlerësohet se ekzistojnë rrethanat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 8 Kriteret e diskualifikimit

1. Zyrtari policor nuk mund të marrë pjesë në proces të gradimit, për arsyet si në vijim:
 - 1.1. Nuk plotëson kriteret e përgjithshme apo kriteret e veçanta;
 - 1.2. Është i suspenduar nga puna për shkak të ngritjes së aktakuzës.
2. Zyrtari policor që momentalisht është i suspenduar me pagesë nga puna dhe nëse suspendimi zgjatë gjatë gjithë procesit të gradimit, ka të drejtë të aplikojë në procesin aktual të gradimit.
3. Zyrtari policor i cili gjatë procesit të gradimit është nën hetime dhe procedura disiplinore nuk ka përfunduar, do të mbetet në pritje për gradim deri në momentin e rezultatit final të hetimit. Nëse hetimet vërtetojnë që zyrtari është i pafajshëm, zyrtari policor gradohet në momentin e parë që hapet pozita e lirë për gradën përkatëse.

Neni 9 Procedura e gradimit

1. Procedura e gradimit zhvillohet në dy (2) faza:
 - 1.1. Faza e aplikimit për kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes; dhe
 - 1.2. vlerësimi profesional.
2. Shpallja e procedurës së aplikimit bëhet nga Departamenti për Burime Njerëzore, pas një analize të nevojave për gradim të stafit, duke marrë parasysh kërkesat specifike për pozita profesionale dhe teknike.
3. Shpallja për aplikim përmban:
 - 3.1. numrin e vendeve të lira për gradën përkatëse;
 - 3.2. kriteret për aplikim për çdo gradë;
 - 3.3. afatin e përfundimit të fazës së aplikimit;
 - 3.4. datën e fillimit të procesit të testimit;
 - 3.5. rregullat, procedurat dhe fazat e konkurrimit;
 - 3.6. referencat e materialit për kandidatët për përgatitje të provimit;
 - 3.7. përqindja që duhet të marrë zyrtari policor për të kaluar nga njëra fazë në tjetrën si dhe minimumi i rezultatit final për të qenë në listë;
 - 3.8. formularin e aplikimit fizik apo elektronik.

4. Shpallja e konkursit për procesin e gradimit bëhet përmes rrjetit të brendshëm elektronik të komunikimit Intranet, web faqes zyrtare të policisë, si dhe përmes dërgimit të njoftimit në mënyrë fizike në të gjitha nivelet e organizimit të policisë.
5. Mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë duhet të sigurohen se zyrtarët relevant të cilët mungojnë pavarësisht arsyeve të mungesës (p.sh: pushimeve, pushimeve të lehonisë, detyra jashtë vendit etj.) të informohen për fillimin e procesit të gradimit
6. Faza e aplikimit përfshinë aplikimin elektronik përmes sistemit PRIMIS. Aplikacionet të cilat nuk i plotësojnë kriteret eliminohen nga procesi. Kandidati i cili për arsye objektive nuk mund të aplikojë në mënyrë elektronike bënë aplikimin në mënyrë fizike.
7. Procesi i gradimit për secilën gradë zhvillohet sa herë që vlerësohet e nevojshme, apo të paktën një (1) herë në dy (2) vite me kusht që ka pozita të lira.

Neni 10

Metodat e vlerësimit profesional

1. Zyrtarët policor që konkurrojnë për ngritje në gradë duhet të përfundojnë me sukses procesin e vlerësimit profesional, varësisht nga grada, si më poshtë:

1.1. Për gradën Rreshter:

- 1.1.1. testin me shkrim;
- 1.1.2. Intervistën me gojë;
- 1.1.3. Vlerësimin e performancës;
- 1.1.4. Verifikimin e së kaluarës;
- 1.1.5. Përfundimi me sukses i trajnimit për mbikëqyrës të vijës së parë.

1.2. Për gradën Toger:

- 1.2.1. testin me shkrim;
- 1.2.2. Intervistën me gojë;
- 1.2.3. Vlerësimin e performancës;
- 1.2.4. Verifikimin e së kaluarës;
- 1.2.5. Përfundimin me sukses të trajnimit përkatës

1.3. Për gradën Kapiten:

- 1.3.1. Zgjidhja e skenarëve;
- 1.3.2. Intervista me gojë;
- 1.3.3. Vlerësimi i performancës;
- 1.3.4. Verifikimi i së kaluarës;
- 1.3.5. Përfundimi me sukses i trajnimit përkatës

1.4. Për gradën Major:

- 1.4.1. Zgjidhja e skenarëve;
- 1.4.2. Intervista me gojë;

- 1.4.3. Vlerësimi i performancës;
- 1.4.4. Verifikimi i së kaluarës dhe
- 1.4.5. Përfundimi me sukses i trajnimit për nivelin e lartë të menaxhimit.

1.5. Për gradën Nënkolonel:

- 1.5.1. intervistën ekzekutive; dhe
- 1.5.2. verifikimin e së kaluarës.
- 1.5.3. Vlerësimi i performancës;

1.6. Për gradën Kolonel:

- 1.6.1. intervistën ekzekutive; dhe
- 1.6.2. verifikimin e së kaluarës.
- 1.6.3. Vlerësimi i performancës;

2. Për të gjitha gradat, në vlerësimin përfundimtar do të llogaritet edhe vlerësimi vjetor i performancës gjatë kohës së qëndrimit në gradën përkatëse si në vijim:

- 2.1 vlerësimi me notën 5, llogaritet 5%;
- 2.2 vlerësimi me notën 4.5 llogaritet 4.5%;
- 2.3 vlerësimi me notën 4 llogaritet 4%;
- 2.4 vlerësimi me notën 3.5 llogaritet 3.5%;
- 2.5 vlerësimi me notën 3 llogaritet 3%;
- 2.6 vlerësimi me notën 2.5 llogaritet 2.5%;

Neni 11 **Testimi me shkrim**

1. Provimi me shkrim bëhet përmes testit në gjuhët zyrtare me qëllim të vlerësimit të njohurive të zyrtarit policor. Testimi bëhet në mënyrë elektronike.

2. Testi me shkrim përbëhet prej 100 pyetjeve me zgjidhje opcionale dhe i paraparë të testojë njohuritë e kandidatit në fushat përkatëse për gradat si në vijim:

2.1 Për gradën rreshter:

- 2.2.1. Njohuritë e përgjithshme të menaxhimit policor dhe të udhëheqjes.
- 2.2.2. Njohuritë për normat kushtetuese më rëndësi për Policinë;
- 2.2.3. Legjislacioni penal dhe procedural penal;
- 2.2.4. Njohuritë për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe qytetarit;
- 2.2.5. Ligjet dhe aktet tjera normative dhe administrative që normojnë veprimtarinë policore,
- 2.2.6. Ligji për komunikacionin rrugor;
- 2.2.7. Politikat dhe procedurat e punës së Policisë së Kosovës dhe

2.2 Për gradën toger:

- 2.2.1 Njohuritë e menaxhimit policor dhe të udhëheqjes.
- 2.2.2 Njohuritë për normat kushtetuese më rëndësi për Policinë;
- 2.2.3 Legjislacionit penal dhe procedural penal;

- 2.2.4 Njohuritë për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe qytetarit;
- 2.2.5 Ligjet dhe aktet tjera normative dhe administrative që normojnë veprimtarinë policore,
- 2.2.6. Ligji për rregullat e komunikacionit rrugor, dhe
- 2.2.7 Politikat dhe procedurat e punës së Policisë së Kosovës.

3. Të gjithë kandidatët njoftohen për rezultatin e tyre individual. Pas përfundimit të testit rezultati shpallet automatikisht për secilin zyrtar policor.

4. Nëse është e mundur testi mbahet në të njëjtën ditë për të gjithë kandidatët përshtimisht në raste të jashtëzakonshme apo emergjente, testi mund të zhvillohet në ditën vijuese.

5. Vetëm zyrtarët policorë që kalojnë me sukses testin me shkrim njoftohen të vazhdojnë procesin e testimit në fazën tjetër.

Neni 12

Intervista me gojë

1. Kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim i nënshtrohen procesit të intervistimit para paneleve të themeluara për këtë qëllim.

2. DZHKP informon kandidatët për kohën, vendin dhe orarin e intervistimit si dhe procedurën e intervistimit. Për Intervistën për gardën Major, Nënkolonel dhe Kolonel, informimin e bënë DDBNJ.

3. Paneli do të testojë aftësitë e kandidatëve për marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e problemeve si dhe potencialin e tyre të mbikëqyrjes për gradën përkatëse. Kjo bëhet duke iu dhënë kandidatëve shembuj të bazuara në situata praktike, për të cilat pritet se zyrtari mund të ballafaqohet si mbikëqyrës i nivelit të gradës përkatëse.

4. Procesi i intervistës ka për qëllim vlerësimin në fushat e mëposhtme, por pa u kufizuar në:

- 4.1 aftësitë komunikuese;
- 4.2 aftësitë e udhëheqjes dhe vendimmarrjen;
- 4.3 njohuritë dhe përvojat profesionale;
- 4.4 aftësitë gjyqesore;
- 4.5 motivimin personal dhe të tjerëve;
- 4.6 marrëdhëniet e punës;
- 4.7 aftësitë për të menaxhuar ndryshimin.
- 4.8 puna ekipore;
- 4.9 menaxhimi i kohës dhe planifikimi.
- 4.10 të drejtat e barabarta, diversiteti dhe angazhimi në komunitet.

5. Vetëm zyrtarët policorë që kalojnë me sukses intervistën me gojë njoftohen të vazhdojnë procesin e testimit në fazën tjetër.

Neni 13

Zgjidhja e skenarëve

1. Secilit kandidat i jepet një skenar nga paneli për tu zgjidhur një situatë të imagjinuar praktike komplekse për nivelin e gradës përkatëse me qëllim të vlerësimit të njohurive të zyrtarit policor për gradim në atë gradë;
2. Kandidatët kanë në dispozicion 10 minuta kohë për të analizuar skenarin dhe përgatitë prezantimin për zgjidhjen e situatës së parashtruar në skenar para panelit vlerësues.
3. Skenari ka për qëllim vlerësimin e kandidatit në zgjidhjen e situatave praktike duke përdorur aftësitë meanxhuese dhe udhëheqëse për nivelin e gradës për të cilën testohet.
4. Kandidati gjatë prezantimit të skenarit mund të përdorë edhe mjetet ndihmëse të cilat sigurohen nga Departamenti i Burimeve Njerëzore.

Neni 14

Intervista ekzekutive

1. Intervista ekzekutive nënkupton vlerësimin e kandidatëve në fushën e menaxhimit strategjik duke përfshirë aftësitë për zhvillim dhe zbatim të planeve strategjike që ndikojnë në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të organizatës, planifikimin e strukturës organizative, shpërndarjen e burimeve, udhëheqjen me iniciativat për ndryshim dhe kontrole të proceseve brenda organizatës si dhe vizion për drejtim të policisë në nivel strategjik.
2. Paraprakisht kandidatëve do t'iu jepet nga një situatë për të prezantuar zgjidhje për rolin dhe pozitën e cila kërkohet për gradim në nivelin e gradës nënkolonel dhe kolonel.
3. Zyrtarët policorë do të kenë në dispozicion shtatë (7) ditë për të përgatitur prezantimin para panelit vlerësues.
4. Pas përfundimit të intervistës, përpilohet lista meritore e kandidatëve të suksesshëm dhe gradimi bëhet varësisht nga pozitat e lira për këto grada.
5. Kandidatët i nënshtrohen intervistës ekzekutive për gradën për të cilën kanë aplikuar paraprakisht.

Neni 15

Llogaritja e Rezultati përfundimtar të testimit

1. Zyrtarët policorë duhet të arrijnë rezultat të përgjithshëm në secilën fazë të testimit prej së paku 70% për tu konsideruar se kanë kaluar fazën përkatëse.
2. Pas përfundimit të intervistës, rezultatet e dy vlerësimeve me shkrim dhe intervistës si dhe vlerësimit të performancës duhet të kombinohen për të dhënë rezultatin përfundimtar.

3. Përqindja e pjesëmarrjes në rezultatin përfundimtarë është 65% e vlerësimit të përgjithshëm i takon testimit me shkrim, 30 % i takon vlerësimit me gojë apo intervistës dhe 5% vlerësimit të performancës.

4. Për dallim nga paragrafi 3 i këtij neni, kandidatët të cilët i nënshtrohen testimit përmes skenarëve dhe intervistës, llogaritja në rezultatin përfundimtarë është 50% i takon testimit përmes skenarit, 45% vlerësimi përmes intervistës dhe 5% vlerësimi i performancës.

5. Zyrtarët policor të cilët i nënshtrohen intervistës ekzekutive duhet të arrijnë rezultat të përgjithshëm prej së paku 70% për tu konsideruar të suksesshëm.

Neni 16

Analiza dhe Rivlerësimi i testit me shkrim

1. DZHPK pas përfundimit të testimit bënanalizën dhe vlerësimin e testit në përgjithësi. Analiza bëhet në bazë të rezultatit specifik të treguar nga kandidatët në secilën pyetje si dhe në bazë të ankesave të kandidatëve.

2. DZHPK analizon dhe shqyrton pyetjet specifike dhe konstatohet nëse pyetja ka gabime teknike, gjuhësore, në përkthim, në formulim të pyetjeve apo alternativave të përgjigjeve të dhëna në test dhe nëse vlerësohet sekëto gabime ndikojnë në rezultat atëherë vendoset që ajo të anulohet duke kalkuluar në favor të gjithë kandidatëve.

3. Nëse vërehen parregullsi të theksuara, DDBNJ përmes zinxhirit komandues mund ti rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm anulimin e tërësishëm apo pjesërisht të testimit përkatës dhe ri-testimin. Rekomandimin për anulim të tërësishëm apo pjesërisht të testimit dhe ri-vlerësimin mund ta bëjë edhe Komisioni mbikëqyrës i procesit.

4. Autoritet për anulim të procesit testues dhe ri-testim është vetëm Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës.

5. Në rast të anulimit të testit me shkrim, Drejtori i Përgjithshëm themelon komision të veçantë për analizimin e procesit të testimit.

Neni 17

Verifikimi i së kaluarës

1. Të gjithë kandidatët të cilët kalojnë me sukses fazat e gradimit: testimin me shkrim, skenarët, intervistën dhe vlerësimin e performancës i nënshtrohen verifikimit të së kaluarës.

2. Hetimi i së kaluarës kryhet nga Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe rezultati i vlerësimit përcillet në DZHPK.

3. Kandidatët pas verifikimit të së kaluarës do të nënshtrohen vendimmarrjes nga Komisioni për gradim. Komisioni duhet të i shqyrtoj dosjet e rasteve, të prezantuara nga Drejtoria e Hetimeve të Brendshme, dosjet e së kaluarës si dhe të dhënat nga Personeli për çdo kandidat.

4. Rastet e vlerësimit të së kaluarës prezantohen para Komisionit për gradim i cili i shqyrton të gjitha rastet dhe vendosë nëse kandidati duhet të kalojë apo dështon në këtë proces.

5. Pas përfundimit të vlerësimit të së kaluarës përgatitet lista meritore e kandidatëve të cilët duhet të ndjekin trajnimin për gradë.

6. Lista meritore me rezultatet, është e vlefshme në afat kohor prej një (1) viti, nga dita e shpalljes së listës finale. Varësisht nga nevojat e Policisë bëhet gradimi i kandidatëve nga lista meritore, duke respektuar renditjen në listë sipas rezultatit. Vlerësimi dhe plotësimi i vendeve të lira duhet të bëhet çdo tre muaj, ndërsa vlerësimi dhe plotësimi përfundimtar i vendeve të lira për të cilat kandidatët në pritje i plotësojnë kriteret e pozitës dhe njësisë duhet të bëhet para skadimit të afatit një (1) vjeçar.

Neni 18

Dispozita të veçanta për kandidatët me pikë të barabarta

1. Kandidatët me pikë të barabarta renditen dhe përzgjidhen sipas kësaj radhe:
 - 1.1. së pari nëse kandidatët janë të gjinive të ndryshme, atëherë përzgjidhet i pari kandidati që i përket gjinisë së nënpërfaqësuar;
 - 1.2. së dyti, nëse njëri nga kandidatët është nga radhët e një komuniteti jo shumicë, atëherë ai përzgjidhet i pari në raport me kandidatin tjetër;
 - 1.3. së treti, nëse kandidatët kanë kohëzgjatje të ndryshme të përvojës në Policinë e Kosovës, atëherë përzgjidhet i pari kandidati që ka përvojë më të gjatë në Policinë e Kosovës;
 - 1.4. së katërti, nëse kandidatët kanë pikë të ndryshme në testin me shkrim, atëherë përzgjidhet i pari kandidati që ka më shumë pikë në testin me shkrim.
2. Gjinia më pak e përfaqësuar sipas paragrafit 1, nën paragrafit 1.3. të këtij neni, përcaktohet nga DZHPK në bazë të statistikave zyrtare.
3. Në rast se nuk mund të aplikohet asnjëra nga alternativat e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, atëherë përzgjedhja bëhet me short.

Neni 19

Hartimi i pyetjeve dhe siguria e testeve

1. DZHPK është përgjegjëse për përgatitjen e pakos së pyetjeve dhe skenarëve për të gjitha fazat e testimit nga e cila pako përzgjidhet një numër i caktuar i pyetjeve dhe skenarëve për secilën fazë të testimit. Në procesin e përgatitjes së pakos DZHPK mund të kërkojë mbështetje me personel kompetent nga Departamentet apo njësitë tjera të PK-së.

2. Komisioni për procesin e gradimeve, ditën e testimit do ta bëjë përzgjedhjen e pyetjeve dhe skenarëve për secilën fazë nga baza e të dhënave të pyetjeve dhe skenarëve të përgatitura nga DZHPK, siç parashihet në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Pyetjet dhe skenarët përgatiten në disa variante për të njëjtën gradë dhe ndryshojnë nga njëra

gradë në gradën tjetër.

4. Të gjitha pyetjet dhe skenarët e testimi të parapara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni duhet të mbahen të sigurt për të ruajtur integritetin e procesit.

5. Materialet e testimi duhet të mbahen të mbyllura për periudhën që nuk përdoren, ruajtja, kontrolli dhe qasja në materialin e testimi rregullohet me procedura standarde të operimit të miratuar nga DDBNJ

6. Siguria e materialeve dhe asgjësimi i materialit të pa nevojshëm detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat e punës së komisionit për mbikëqyrjen e procesit të gradimeve me hollësisht do të rregullohet procedurë standarde të operimit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

7. Drejtori i DDBNJ përgatitë pakon e pyetjeve të intervistës ekzekutive e cila miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë. DDBNJ kujdeset për integritetin e pakos së intervistës ekzekutive të cilat mbahet konfidencial gjatë gjithë procesit të gradimit.

Neni 20

Komisioni për procesin e gradimeve

1. Me propozimin e Drejtorit të Departamentit për Burime Njerëzore, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë me vendim themelon Komision përkatës për procesin e gradimit për gradat rreshter, toger, kapiten dhe major.

2. Njëri nga anëtarët e Komisionit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni caktohet në cilësi të Kryesuesit të Komisionit.

3. Komisioni është trup i pavarur, kompetent për mbikëqyrjen e procesit të gradimit të zyrtarëve policorë dhe shqyrtimin e ankesave gjatë procesit.

4. Komisioni funksionon nën autoritetin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

5. Komisioni përbëhet nga së paku prej tre (3) anëtarëve. Në cilësinë e vëzhguesve në proces mund të marrin pjesë një zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme i propozuar nga Sekretari i Ministrisë, përfaqësues i Sindikatës së Policisë dhe përfaqësues nga IPK. Komisioni duhet sa here që është mundshme të ketë baraspeshë etnike dhe gjinore.

6. Në Komisione nuk duhet emëruar zyrtar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore të Policisë, dhe zyrtar që kanë masë disiplinore aktive për shkelje të rëndë disiplinore.

7. DZHPK i ofron Komisionit për procesin e gradimit mbështetje teknike dhe administrative.

8. Procedurat e Punës së Komisionit më në detaje do të rregullohen me PSO të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 21

Përgjegjësitë e Komisionit për procesin e gradimeve

1. Komisioni për procesin e gradimit mbikëqyrë procedurat e kontrollimit të testit me shkrim.
2. Komisioni për procesin e gradimit është kompetent dhe përgjegjës për shqyrtimin e ankesave nga zyrtarët policorë, në të gjitha fazat e procesit të gradimit dhe marrjen e vendimeve lidhur me ankesat përfshirë edhe vendimin për kandidatët të cilët nuk e kanë kaluar me sukses fazën e verifikimit.
3. Secili proces i gradimit do të ketë komisionin përkatës. Anëtarët e komisioneve duhet të kenë së paku një gradë më të lartë se zyrtarët policorë që i nënshtrohen procesit të gradimit për atë gradë.
4. Komisioni për procesin e gradimit është përgjegjës për të siguruar se procesi i gradimit është duke u zhvilluar në bazë të parimeve udhëzuese e në veçanti për mënyrën transparente, objektive dhe jo diskriminuese, në pajtim me ligjin, me këtë udhëzim administrativ, dhe aktet tjera të brendshme.
5. Komisioni për procesin e gradimit në rastet e shqyrtimit të ankesave mblidhet sipas nevojës me qëllim të mbarëvajtjes së procesit dhe vendosjes për ankesat.
6. Kryesuesi i Komisionit udhëheqë me punën e Komisionit për procesin e gradimit.
7. Në përfundim të procesit të gradimit, Komisioni për procesin e gradimit analizon tërë procesin e gradimit dhe në fund përgatitë raportin përfundimtar për Drejtorin e Përgjithshëm.

Neni 22

Paneli intervistues për gradim

1. Me qëllim të vlerësimit të zyrtarëve policor në fazën e intervistës, zgjedhjes së skenarëve dhe intervistës ekzekutive themelohen Panele të veçanta. Anëtarët e panelit nuk mund të jenë të njëjtit në përbërje të paneleve intervistës, zgjedhjes së skenarëve dhe intervistës ekzekutive.
2. Panelet themelohen me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm pas propozimit të Drejtorit të Departamentit për Burime Njerëzore, për procesin e gradimit për gradat rreshter, toger, kapiten dhe major. Në cilësinë e vëzhguesve në proces mund të marrin pjesë një zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme i propozuar nga Sekretari i Ministrisë, përfaqësues i Sindikatës së Policisë dhe përfaqësues nga IPK.
3. Për qëllime të intervistës ekzekutive me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm themelohet Paneli për intervistë i përbërë nga tre anëtarë nga niveli i Menaxhmentit i Lartë i Policisë.
4. Njëri nga anëtarët e panelit të përcaktuar në këtë nen caktohet në cilësi të Kryesuesit të Panelit.
5. Panelet përbëhen nga së paku prej tre (3) anëtarëve të cilët kanë të kryer trajnim të veçantë

intervistim. Paneli duhet sa here qe është mundur dhe e domosdoshme të ketë baraspeshë etnike dhe gjinore.

6. Paneli i përmbahet pakos së pyetjeve dhe skenarëve të përgatitura paraprakisht. Gjithashtu paneli mund të parashtron edhe pyetje tjera shtesë që shërbejnë për të arritur qëllimin e intervistës.

7. Procedurat e Punës së panelit, përshirë format më në detaje do të rregullohen me PSO të miratuar nga DDBNJ.

Neni 23

Procedura e veçante e testimit për gradë

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, me qëllim të sigurimit të përfaqësimit gjinor dhe etnik, mund të organizoj proces të veçantë të gradimit, ku të drejtë aplikimi kanë vetëm gratë, apo vetëm pjesëtarët e komuniteteve të nënpërfaqësuar.

2. Kandidatët e suksesshëm gradohen bazuar ne nevojat e identifikuar paraprakisht për pozita të lira në kuadër të Policisë së Kosovës.

3. Përfundimisht nenit 17 të këtij udhëzimit, Drejtori i Përgjithshëm mund të shpallë procedurë të veçantë të gradimit për pozita një njësi specifike, edhe gjatë periudhës së vlefshmërisë së listës meritore.

Neni 24

Procedurat e ankesave

1. Çdo ankesë në procesin e gradimit, parashtrohet në afatin pesëmbëdhjetë (15) ditë, nga data e shpalljes së listës me rezultate përfundimtare. Ankesat e parashtruara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim;

2. Ankesat parashtron në DZHPK në mënyre elektronike apo fizike,

3. DZHPK ka për detyrë që ankesat ti përcjell në Komisionin për Gradim i cili i shqyrton dhe të vendosë lidhur me ankesat.

4. Procedura e parashtrimit të ankesës zhvillohet sipas procedurës së përcaktuar në vazhdim:

4.1 Pas çdo faze të testimit zyrtari policor ka të drejtë ankese. Ankesat duhet të bëhen me shkrim dhe të drejtuara në çështje specifike dhe faktike.

4.2 Në fazën e aplikimit, pas njoftimit të zyrtarit policor për statusin e tij në këtë proces, ankesa mund të bëhet personalisht, përmes shërbimit postar apo postës elektronike, brenda tre (3) ditë pune.

4.3 Testi me shkrim - Zyrtari policor pas publikimit të rezultatit të testimit e ka të drejtën e ankesës brenda tre (3) ditë pune.

4.4 Intervista me gojë, përfshirë skenarin - Zyrtari policor pas publikimit të rezultatit të intervistës me gojë dhe skenar e ka të drejtën e ankesës brenda tre (3) ditë pune.

5. Me pranimin e ankesës, Komisioni për proces të gradimit duhet t'i shqyrtoj ankesat dhe të merr vendim në afatin kohor brenda 72 orëve.

6. Ankesat e parashtruara e pezullojnë procesin e gradimit dhe promovimin në gradë deri në nxjerrjen e vendimit.

Neni 25

Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve përfundimtare

1. Testi me shkrim në të gjitha rastet kontrollohet në mënyrë elektronike apo fizike menjëherë pas përfundimit të testit. Nëse testi me shkrim zhvillohet në mënyrë elektronike, rezultati shpallet automatikisht.
2. Nëse zyrtari policor nuk ka plotësuar të dhënat individuale si dhe të dhënat e kërkuara në fletë përgjigjen e testit sipas udhëzimeve, vlerësohet me zero pikë.
3. Nëse zyrtari policor nuk ka plotësuar përgjigjen sipas udhëzimeve të dhëna, pavarësisht përgjigjes së tij, ai nuk do të rivlerësohet për përgjigje.
4. Rezultatet e testit me shkrim publikohen në vend të dukshëm, menjëherë pas nxjerrjes së rezultateve.
5. Në çdo rast pas përfundimit të testimit për intervistën me gojë, përfshirë skenarin dhe zgjidhjen e problemit sipas skenarëve, paneli vlerësues duhet të përfundoj vlerësimin e zyrtarit policor dhe fletë vlerësimin ia dorëzon personit përgjegjës për administrim të procesit, para se të vazhdojë vlerësimi për zyrtarin policor pasardhës.
6. Rezultati i intervistës me gojë, përfshirë skenarin, publikohet brenda dy ditëve pune nga përfundimi i testimit përkatës.
7. Publikimi i listës përfundimtare për të gjitha fazat do të bëhet në mënyrën siç është paraparë në me këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 26

Dhënia e gradës dhe caktimi në pozitë

Kandidatët të cilët kanë kaluar me sukses të gjitha fazat e gradimit, marrin gradën përkatëse dhe emërohen në pozitën përkatëse në pajtim me gradën dhe kriteret e vendit të lirë të punës.

Neni 27

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2019 për procedurën e gradimit për zyrtarët policorë, të datës 03.07.2019.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kolonel Gazmend HOXHA

Drejtore i Përgjithshëm i Policisë

Datë: 22/05/2026

Prishtinë